



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
MINISTRI

7435/2
Nr. ___ Prot.

Tiranë, më 26/11/2020

URDHËR

Nr. 379 datë 26/11/2020

“PËR
ZGJEDHJEN E ANËTARIT TË KOMISIONIT DISIPLINOR TË PËRMBARUESVE
GJYQËSORË PRIVATË”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 7, pika 2, të ligjit nr.8678, datë 14.05.2001 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, të shkronjës “b”, të pikës 1 dhe pikës 2, të nenit 73 të ligjit nr.26/2019 “Për shërbimin përbarimor gjyqësor privat”, si dhe të Urdhrit të Ministrit të Drejtësisë nr. 197, datë 26.6.2020 “Për miratimin e rregullave të hollësishme për paraqitjen dhe trajtimin e shprehjeve të interesit, si dhe verifikimin e plotësimit të kushteve ligjore për anëtarë të Komisionit Disiplinor të Përbaruesve Gjyqësorë Privatë”,

KONSTATOJ:

Në zbatim të kërkesës së shprehjes së interesit të publikuar në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare, nr.6547, datë 19.10.2020, janë paraqitur kandidaturat të cilat kanë shprehur interes në lidhje me Komisionin Disiplinor të Përbaruesve Gjyqësorë Privatë, në referim të pikës 1, të nenit 73, të Ligjit nr. 26/2019 “Për shërbimin përbarimor gjyqësor privat”, ku 1 anëtar zgjidhet nga Ministri i Drejtësisë.

Në zbatim të Urdhrit të Ministrit të Drejtësisë nr.368, datë 06.11.2020 “Për ngritjen e grupit të punës për trajtimin e shprehjeve të interesit, si dhe verifikimin e plotësimit të kushteve ligjore për anëtarë të Komisionit Disiplinor të Përbaruesve Gjyqësorë Privatë”, është vijuar me trajtimin e kandidatave të paraqitura dhe verifikimin e plotësimit të kushteve ligjore.

Kandidati z.Erind Merkuri, ka përcjellë dokumentacionin e kërkuar në Urdhrin e Ministrit të Drejtësisë nr.197, datë 26.06.2020 “Për miratimin e rregullave të hollësishme për paraqitjen dhe trajtimin e shprehjeve të interesit, si dhe verifikimin e plotësimit të kushteve ligjore për anëtarë të Komisionit Disiplinor të Përbaruesve Gjyqësorë Privatë”, brenda afatit ligjor të përcaktuar në shprehjen e interesit të publikuar në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare.

Sipas dokumentacionit të përcjellë, rezulton se z.Merkuri ka marrë gradën shkencore “Doktor”, me nr.1351, datë 09.05.2016, të lëshuar nga Universiteti i Tiranës, në fushën “Aspekte procedurale të gjyqimit kushtetues”.

Në zbatim të pikës 1, të nenit 87, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, sipas të cilit *“Përpara se të merret vendimi përfundimtar, organi publik, përveç rasteve të parashikuara nga neni 64, i këtij Kodi, njofton palën e lidhur me të drejtën e saj për t’u dëgjuar”*, u zhvillua një seancë dëgjimore në ambientet e Ministrisë së Drejtësisë në datë 24.11.2020.

Duke qenë se në përzgjedhjen e anëtarëve të Komisionit Disiplinor kanë përparësi kandidatët që zotërojnë titull ose gradë shkencore, eksperiencë profesionale shkencore në çështjet e së drejtës civile, si dhe duke marrë shkas nga përvoja si avokat pranë Shoqërisë Meksi Law and Consulting, është vlerësuar kualifikimi i kandidatit të z.Erind Merkuri.

Sa më sipër, në kushtet kur z.Erind Merkuri përmbush kriteret ligjore të përcaktuara në pikën 2, të nenit 73 të Ligjit nr.26/2019 *“Për shërbimin përbarimor gjyqësor privat”*,

URDHËROJ:

1. Zgjedhjen e z.Erind Merkuri si anëtar të Komisionit Disiplinor të Përbaruesve Gjyqësorë Privatë.
2. Mandati si anëtar i Komisionit Disiplinor të Përbaruesve Gjyqësorë Privatë, fillon në datë 1.12.2020 dhe përfundon në datë 30.11.2024.
3. Ngarkohet z. Erind Merkuri, që brenda 10 ditëve nga zgjedhja e anëtarëve të Komisionit, të thërrasë mbledhjen e parë të Komisionit.
4. Ngarkohet Sektori i Arkiv-Protokollit për marrjen e masave dhe njoftimin e këtij Urdhri, Z.Erind Merkuri, Dhomës Kombëtare të Përbaruesve Gjyqësorë Privatë, si dhe Shkollës së Magjistraturës.
5. Ky Urdhër publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë dhe në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI
Etilda Gjonaj (Saliu)

